

Pas lutjeve të së premtes në qytete të ndryshme të Egjiptit janë mbajtur protesta kundër grushtit të shtetit, raporton Anadolu Agency (AA).

Pas thirrjes së bërë nga Aleanca Kombëtare kundër grushtit të shtetit dhe në mbështetje të legjitimitetit, pas lutjes të së premtes (faljes së xhumasë) protestuesit janë mbledhur në Kajro, Giza, Beni Suvejf, Zakazik, Sharkije, Mansura, Hilvan, Asjot, Bahira, Kefrudevar, Fejum, Dakahlje dhe Dimjat për të protestuar kundër qeverisë.

Protestuesit kanë mbajtur në duar flamujt e Egjiptit dhe posterat e presidentit të rrëzuar Muhamed Mursi dhe gjithashtu kanë brohoritur kundër grushtit të shtetit. Protestuesit gjithashtu kanë kërkuar që të lirohen të burgosurit.